



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 150, Datë 10 .09.2020

MBI

DISA SHTESA NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 105/2020, MIRATIMIN E OFICERIT TË PËRPUTHSHMËRISË (ZP)-SË TAP DHE KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 16 dhe 19 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe nenit 15 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, nenit 5 gërma c, të “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 65, datë 26.03.2018, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.09.2020, mbasi shqyrtoi relacionin dhe draftin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror për Miratimin e oficerit të përputhshmërisë (ZP) të TAP, konstatoi se:

Duke patur parasysh që:

- Me vendimin e bordit të ERE nr. 105/2020, është vendosur për miratimin e zyrtarit të përputhshmërisë (zp) së TAP dhe kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë.
- Në datë 15.09.2020, Autoriteti Rregullator i Italisë ARERA, miratoi kandidatin e propozuar nga TAP Ag, si Zyrtar i Pajtueshmërisë.
- Në datë 17.09.2020, Autoriteti rregullator i Greqisë, miratoi kandidatin e propozuar nga TAP Ag, si Zyrtar i Pajtueshmërisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa shtesave në vendimin e bordit të ERE Nr. 105/2020, si më poshtë :

Në konstatimet e vendimit Nr. 105/2020 shtohen :

- *Duke patur parasysh komunikimin e datës 8 shtator 2020, ku TAP vendosi në dispozicion autoriteteve, RAE, ARERA dhe ERE, një program të ri të pajtueshmërisë i cili është i integruar me masat e vendosura mbi të, nga vendimi i certifikimit dhe tregoi kandidatin e ri për rolin e zyrtarit të pajtueshmërisë me disa shtesa të cilat u pasqyruan në të;*
- *Dokumenti i sipër përmëndur përmban, ndër të tjera, masat për të siguruar pavarësinë e menaxhimit dhe stafit të kompanisë si dhe masat e vendosura për të siguruar përpunimin e informacionit të ndjeshëm tregtar;*
- *Duke patur parasysh se kandidati për rolin e zyrtarit të pajtueshmërisë i rekomanduar nga TAP AG, bazuar në dokumentacionin e siguruar, posedon kushtet e nevojshme të pavarësisë dhe profesionalizmit të parashikuara nga rregulloret në fuqi;*

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-S.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI